



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

# **Shqyrtim i rasteve penale për mosdeklarim të pasurisë nga zyrtarët e lartë publikë**

**nëntor 2015**

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	1
2. Korniza ligjore ndërkombëtare dhe vendore .....	2
2.1 Korniza ligjore ndërkombëtare .....	2
2.2 Korniza ligjore vendore .....	2
3. Shqetësimet lidhur me reagimet për mosdeklarimin e pasurisë në kohë .....	4
3.1 Vërejtjet e përgjithshme lidhur me interpretimin e ligjit nga autoritetet përgjegjëse ..	4
3.1.1 Kërkesat e elementit material dhe të vetëdijes në kontekstin e Kodit Penal dhe Ligjin për deklarimin e pasurisë .....	4
3.1.2 Detyrimi për deklarimin e pasurisë në kontekstin e Kodit Penal dhe Ligjit për deklarimin e pasurisë .....	6
3.2 Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kundër Korrupsionit.....	6
3.2.1 Verifikimi nëse zyrtarët janë njoftuar nga zyrtari kontaktues .....	6
3.2.2 Ngritja me automatizëm e kallëzimeve penale për mosdeklarim të pasurisë .....	7
3.2.3 Caktimi dhe trajnimi efektiv i zyrtarëve kontaktues.....	8
3.3 Çështjet lidhur me ndjekjen penale.....	8
3.3.1 Veprime të ndryshme pas pranimit të kallëzimit penal .....	8
3.3.2 Përdorimi jo i duhur i aktakuzave të drejtpërdrejta .....	9
3.3.3 Aktakuzat me arsyetime të mangëta .....	9
3.3.4 Mospërdorimi i alternativave .....	10
3.4 Çështjet që kanë të bëjnë me gjykatat.....	11
3.4.1 Mosverifikimi nëse të pandehurit ishin vënë në dijeni nga zyrtari kontaktues për detyrimin për ta deklaruar pasurinë .....	11
3.4.2 Dështimi për t'i mbrojtur të drejtat e të pandehurve të papërfaqësuar .....	12
3.5 Rast ilustrues për studim.....	13
4. Përfundime .....	15
5. Rekomandime .....	15

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton reagimin e institucioneve të Kosovës ndaj mosdeklarimit me kohë të pasurisë nga zyrtarët e lartë publikë sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë.<sup>1</sup> Ligji për deklarimin e pasurisë obligon zyrtarët e lartë publikë që ta deklarojnë pasurinë e tyre 30 ditë nga marrja e postit të ri dhe pastaj në baza vjetore. Meqë kërkojnë zbulimin e pasurisë në mënyrë të hapur, deklaratat e pasurisë janë vegël me rëndësi jetike për të siguruar transparencë dhe luftim të korrupsionit dhe për më tepër mundësojnë kontrollin e prejardhjes së pasurisë. Prandaj, ndjekja e duhur penale e mosdeklarimit të pasurisë është tejet e rëndësishme për luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Që nga janari 2013, mosdeklarimi i pasurisë trajtohet si vepër penale. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka shqyrtuar raste të tilla të paraqitura gjatë periudhës 2013 – 2014 dhe ka analizuar administrimin e tyre deri në tetor 2015. Vlerësimi i OSBE-së tregon se në praktikë ka mungesë të njëtrajtshmërisë në trajtimin e këtyre rasteve nga institucionet gjegjëse: Agjencia Kundër Korrupsionit, prokuroritë dhe gjykatat. Kjo mungesë e njëtrajtshmërisë ka për pasojë përfundime të kundërta, madje edhe kur rrethanat themelore të rasteve janë gati identike, me implikime negative për garancinë e sigurisë ligjore dhe barazisë para ligjit, siç përcaktohet me kornizën ligjore të Kosovës. Ajo gjithashtu minon zbatimin e kësaj vegle kritike kundër korrupsionit duke e mbingarkuar sektorin e drejtësisë me raste që realisht nuk do të duhej të ishin ngritur.

Raporti ka identifikuar shqetësimet vijuese: interpretim të tillë të ligjit që rezulton me një numër rastesh të ngritura në gjykatë pa prova të duhura që dëshmojnë se zyrtarë e lartë publikë janë informuar nga zyrtarët kontaktues për obligimin për ta deklaruar pasurinë; dështim në ofrimin e udhëzimeve dhe trajnimeve për zyrtarët kontaktues, që janë persona të caktuar në të gjitha institucionet e qeverisë me përgjegjësi për t'i njoftuar zyrtarët e lartë publikë për obligimin e deklarimit të pasurisë; mospërputhje brenda dhe ndërmjet zyrave të prokurorisë se si duhen adresuar rastet; dështim në zbatimin e mjeteve alternative në vend të ndjekjes penale; akt padi, vendime dhe aktgjykime gjyqësore që nuk përmbajnë arsyetime adekuate, duke përfshirë edhe çështjen se a janë njoftuar ose jo si duhet zyrtarët e lartë publikë për obligimin e deklarimit; dhe shkallë e ulët e përfaqësimit nga avokatët mbrojtës.

Përkundër sfidave të vërejtura në zbatimin dhe gjykimin e këtyre rasteve, raporti vë në dukje edhe zhvillimet pozitive lidhur me shqetësimet e identifikuar. Në shkurt 2014, Agjencia Kundër Korrupsionit filloi me trajnimin e zyrtarëve kontaktues për rolin dhe përgjegjësitë e tyre dhe në mars 2015 publikoi një doracak në shërbim të tyre. Doracaku udhëzon zyrtarët kontaktues që të njoftojnë të gjithë zyrtarët e lartë publikë mbi përgjegjësinë e tyre për të deklaruar dhe ta dokumentojnë këtë njoftim për përdorim të mëvonshëm, që është hap i rëndësishëm duke e pasur parasysh nevojën për të përcaktuar se zyrtarët e lartë publikë janë informuar, në mënyrë që të krijohet përgjegjësia penale për mosdeklarim. Veç kësaj, zyra e kryeprokurorit është angazhuar për harmonizimin e praktikës prokuroriale në raste të kësaj natyre dhe ka inkurajuar përdorimin e alternativave në vend të ndjekjes penale. Megjithatë, nevojitet më shumë angazhim për harmonizimin e praktikave dhe për sigurimin e zbatimit të njëtrajtshëm të ligjit. Raporti përfundon me rekomandime për asistimin të mëtutjeshëm të aktoreve gjegjës në përpjekjet e tyre për harmonizim të praktikave.

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-50 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, 14 shtator 2011, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-228 për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 04/L-50 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji për deklarimin e pasurisë), 7 prill 2014.

## 1. HYRJJE

Ky raport paraqet gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi i OSBE-së i rasteve penale të ngritura gjatë 2013-2014 kundër “zyrtarëve të lartë publikë” për mosdeklarim të pasurisë sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë, duke e analizuar administrimin e tyre deri në tetor 2015. Para hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal të Kosovës<sup>2</sup> (Kodi Penal) në janar 2013, mosdeklarimi i pasurisë apo paraqitja e deklarimeve të rrejshme ose të pasakta përbënte kundërvajtje. Megjithatë, që nga viti 2013 mosraportimi i pasurisë ose plotësimi dhe dorëzimi i raporteve të rrejshme dhe të pasakta përbën vepër penale sipas nenit 437 të Kodit Penal.

Raporti bazohet në analizën e 52 rasteve lidhur me deklarimin e pasurisë të ngritura gjatë periudhës 2013-2014, komunikimin me zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit në mars 2015 për të kuptuar qëndrimin e saj përkitazi me atë se si duhen trajtuar deklarimet e pasurisë, komunikimin me gjyqtarë dhe prokurorë të përfshirë në raste të deklarimit të pasurisë për të ndjekur zhvillimet në raste specifike, deklaratat e bëra në qershor 2015 në punëtorinë me prokurorë të organizuar me Zyrën e Kryeprokurorit për t’i diskutuar praktikën e ndryshme në rastet e deklarimit të pasurisë brenda dhe ndërmjet zyrave të ndryshme të prokurorisë në Kosovë, si dhe shqyrtimin e administrimit të 162 kallëzimeve penale të ngritura nga Agjencia Kundër Korrupsionit ndërmjet 2013-2014.

OSBE-ja ka shqyrtuar 63 raste nga 162 kallëzimet penale të paraqitura nga Agjencia Kundër Korrupsionit në prokurori nga janari 2013 deri më dhjetor 2014, nga të cilat 52 janë gjetur të jenë të ndërlidhura me dështim për deklarim të pasurisë, ndërsa 11 rastet e mbetura lidheshin me gabime të bëra në dorëzimin e deklaratave. Nga 52 rastet që janë fokus i këtij raporti, vendimet në kërkesa për hedhje poshtë të aktakuzave ose aktgjykime janë nxjerrë në 24 raste, ndërsa rastet e mbetura ose janë ende në prokurori ose në gjykatë në pritje të fillimit të procedurave, ashtu siç ishte gjendja deri në fund të tetorit 2015. Në vlerësimin e trajtimit të 52 rasteve, OSBE ka shikuar jo vetëm të dhënat statistikore lidhur me administrimin e tyre, por ka analizuar edhe shtatë kallëzime penale, 21 aktakuzat, katër vendime për refuzim të aktakuzës dhe 20 aktgjykime, si dhe ka monitoruar drejtpërdrejt seancat në 15 raste para gjykatës.

162 kallëzime penale të paraqitura nga Agjencia Kundër Korrupsionit në prokurori kishin të bënin ose me mosdeklarimin e pasurisë ose me pasaktësitë në deklarimet e bëra, sipas të dhënave të siguruar nga prokuroria për OSBE-në. Të dhënat e siguruar nga prokuroria nuk i kategorizojnë 162 kallëzimet penale sipas dështimit për të paraqitur deklarime të pasurisë sipas nenit 437(1) të Kodit Penal dhe pasaktësive në deklaratat e paraqitura sipas nenit 437(2) të të njëjtit Kod. Prandaj, kategorizimi i rasteve sipas këtyre shkeljeve nuk mund të dihet sipas të dhënave në dispozicion të OSBE-së. Duket theksuar se rastet që i takojnë pasaktësive në deklarime, sipas nenit 437(2), ishin përtej qëllimit të këtij raporti.

Monitorimi i OSBE-së tregon mungesë njëtrajtshmërie në praktikë në të tre institucionet relevante përgjegjëse në rastet penale lidhur me deklarimin e pasurisë – Agjencia Kundër Korrupsionit, prokuroritë dhe gjykatat – dhe shumë raste ku e drejta materiale dhe procedurale nuk janë zbatuar si duhet. Mospërputhjet e tilla kanë implikime negative në garantimin e sigurisë ligjore dhe barazisë para ligjit, siç garantohet në kornizën ligjore të Kosovës.

---

<sup>2</sup> Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Kosovës, 1 janar 2013.

Raporti përfundon me një serie rekomandimesh që synojnë rregullimin e shqetësimeve të zbuluara në monitorimin dhe vlerësimin e OSBE-së me qëllim të përmirësimit të mundësive së institucioneve relevante në respektimin e të drejtave të personave të përfshirë në raste penale lidhur me deklarimin e pasurisë.

## 2. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE VENDORE

### 2.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

Ashtu si u përmend më sipër, raporti analizon zbatimin e Ligjit për deklarimin e pasurisë nga institucionet përkatëse të Kosovës dhe gjen qasje të ndryshme të jetësuar qoftë nga ato apo edhe brenda vetë tyre. Ashtu siç është përcaktuar në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, zbatimi i njëtrajtshëm dhe i parashikueshëm i ligjit është komponentë kyçe e sundimit të ligjit, si dhe për të drejtën për barazi para ligjit dhe gjykim të drejtë.<sup>3</sup> Këto standarde ndërkombëtare garantohen me kornizën ligjore të Kosovës. Korniza ligjore e Kosovës garanton barazi para ligjit, duke përfshirë këtu që Kosova “qeveriset në mënyrë demokratike me respektim të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve të saj legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore” dhe se ushtrimi i funksionit publik “bazohet në parimet e barazisë së të gjithë individëve para ligjit.”<sup>4</sup> Ngjashëm, korniza ligjore e Kosovës gjithashtu garanton “mbrojtje të njëjtë të të drejtave në procedurë para gjykatës, autoriteteve të tjera shtetërore dhe bartësve të pushtetit publik.”<sup>5</sup> Siç do të tregohet më poshtë, mungesa e njëtrajtshmërisë në zbatimin e Ligjit minon këto garanci të individëve dhe zbatimin efektiv të rasteve të mosdeklarimit të pasurive.

### 2.2 Korniza ligjore vendore

Ligji për deklarimin e pasurisë përkufizon, mes tjerash, personat që duhet të deklarojnë pasurinë, procedurën për njoftimin e personave që duhet të deklarojnë pasurinë, kohën kur duhet të bëhen dorëzimet dhe në çfarë mënyre. Secila prej këtyre çështjeve është themelore për të përcaktuar nëse një person ka kryer vepër penale sipas nenit 437(1) të Kodit Penal.

Ligji për deklarimin e pasurisë përcakton që të gjithë “zyrtarët e lartë publikë” të listuar në Ligj duhet ta deklarojnë pasurinë.<sup>6</sup> Sipas Ligjit, çdo institucion qeverisës duhet ta caktojë një zyrtar kontaktues, i cili vepron si koordinator i aktiviteteve me Agjencinë Kundër Korrupsionit.<sup>7</sup> Zyrtari kontaktues, i cili duhet të jetë nga zyra e personelit, është përgjegjës për njoftimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për zyrtarët në institucione që janë përgjegjës për dorëzimin e deklaratave, *njoftimin e zyrtarëve të lartë publikë në institucion për obligimin e tyre për të paraqitur deklaratën*, dhe regjistrimin e dhuratave të pranuar nga zyrtarët në ushtrim të detyrave të tyre.<sup>8</sup> Zyrtarë të lartë publikë duhet të paraqesin deklaratë të pasurisë brenda 30 ditësh nga marrja e

<sup>3</sup> Shih Aktgjykimin në rastin *Popov kundër Moldavisë* e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ), 6 dhjetor 2005 (“E drejta për proces të drejtë gjyqësor para tribunalit siç garantohet me nenin 6 § 1 të Konventës duhet të interpretohet në konsideratë të Preambulës së Konventës, e cila, në pjesën relevante të saj, e deklaron sundimin e ligjit pjesë të trashëgimisë së përbashkët të [palëve]. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë ligjore.”); *Ištván dhe Ištvánová kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i GJEDNJ i 12 qershorit 2012 (siguria ligjore kërkon konsistencë në vendimmarrje gjyqësore në mënyrë që të krijohen “udhëzime dhe rezultate të parashikueshme”).

<sup>4</sup> Kushtetuta e Kosovës, neni 3, 15 qershor 2008.

<sup>5</sup> *Po aty*, neni 31(1).

<sup>6</sup> Shih nenin 3, Ligji për deklarimin e pasurisë, *shënimi* i mësipërm 1.

<sup>7</sup> *Po aty*, neni 3(1.5).

<sup>8</sup> *Po aty*, neni 4.

detyrës zyrtare dhe që më pas të vazhdojnë me paraqitjen e deklaratave çdo vit nga 1 deri më 31 mars.<sup>9</sup> Deklaratat duhet të dorëzohen në Agjencinë Kundër Korrupsionit personalisht nga zyrtari i lartë publik ose nga personi i autorizuar nga zyrtari i lartë publik.<sup>10</sup> Përfundimisht, neni 17(1) i Ligjit për deklarimin e pasurisë thotë që “Agjencia [Kundër Korrupsionit] paraqet kallëzim penal në zyrën kompetente të prokurorisë kundër zyrtarit të lartë publik që shkel obligimet e përcaktuara me Ligj, që përbën veprë penale sipas Kodit Penal.”

Neni 437(1) i Kodit Penal thotë që: “çdo person, i obliguar me ligj që të deklarojë pronën, të hyrat, dhuratat, përfitimet e tjera materiale ose detyrimet financiare, i cili nuk i deklaron ato do të dënohet me gjobë apo burgim deri në tre (3) vite. Shkelja e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni konsiderohet të jetë kryer kur afati për dorëzimin e deklaratës së pasurisë kalon e raportimi nuk është bërë.”<sup>11</sup>

Nëse lexohet ndaras, neni 437(1) duket se vendos standard të rreptë të përgjegjësisë ku vetëm dështimi për të dorëzuar deklaratë të pasurisë rezulton me shkelje penale. Megjithatë, ky nen duhet lexuar në kontekst të Kodit Penal si tërësi, i cili përshkruan përgjegjësinë penale vetëm atëherë kur veprimi apo mosveprimi është kryer me qëllim apo nga neglizhenca. Vepra konsiderohet e qëllimshme qoftë kur personi është i vetëdijshëm dhe dëshiron ta kryejë atë, apo kur personi është i vetëdijshëm se mund ketë pasoja kundërligjore si rezultat i veprës dhe lejon kryerjen e saj.<sup>12</sup> Përgjegjësia penale për neglizhencë, nga ana tjetër, vlen vetëm kur ligji e përcakton atë shprehimisht, që nuk është ashtu në nenin 437(1)<sup>13</sup>. Për më tepër, personi nuk bart përgjegjësi penale nëse, në kohën e kryerjes së veprës, për arsye të justifikueshme, nuk e ka ditur ose nuk ka pasur mundësi ta dijë se një akt i tillë është i ndaluar.<sup>14</sup> Gjithashtu, personi nuk ka përgjegjësi penale nëse, në kohën e kryerjes së veprës, ka besuar gabimisht se kanë ekzistuar rrethana, të cilat po të kishin ekzistuar në të vërtetë, do ta bënin veprën të lejueshme.<sup>15</sup> Prandaj, në mënyrë që të caktohet përgjegjësia penale duhet të paraqiten fakte shtesë, të tilla që tregojnë se zyrtari gjegjë *ka pasur dijeni* për kërkesën për raportimin e pasurisë me deklaratë dhe që ai *qëllimisht* nuk e ka deklaruar pasurinë (thënë ndryshe, nuk ka dështuar të deklarojë pasurinë për shkak të neglizhencës ose gabimit).

Nëse shpallet fajtor për veprën penale sipas nenit 437(1), ndikimi i një shpalljeje të tillë të fajësisë mund të shkojë përtej sanksioneve penale të përcaktuara në Kodin Penal, në mënyrë të tillë që prek punësimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të lartë publikë. Për shembull, sipas Ligjit për shërbimin civil, nëse një nëpunës civil shpallet fajtor për kryerje të një veprë penale “me elementë që përbëjnë shkelje të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil” punëdhënësi publik duhet të fillojë procedurën për shkarkim nga detyra.<sup>16</sup> Ngjashëm, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale “këshilltari [i kuvendit komunal] do të largohet nga detyra e këshilltarit komunal ... (d) nëse anëtar i dënohet për kryerje të veprës penale me vendim të gjykatës.”<sup>17</sup> Kryetarët e

<sup>9</sup> *Po aty*, neni 7 dhe 8.

<sup>10</sup> *Po aty*, neni 6(3).

<sup>11</sup> Shih nenin 437(2), Kodi Penal, që rregullon situatat ku deklarimet janë bërë me kohë por përmbajnë lëshime në ofrimin e informacioneve që kërkohen me ligj, ose përmbajnë informacione të rrejshme, i cili përcakton gjoba dhe burgim nga gjashtë muaj e deri në pesë vite, shënimi i mësipërm 2.

<sup>12</sup> *Po aty*, neni 21.

<sup>13</sup> *Po aty*, neni 17 dhe 25(2).

<sup>14</sup> *Po aty*, neni 26.

<sup>15</sup> *Po aty*, neni 25.

<sup>16</sup> Shih nenin 63, Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil, 13 maj 2010.

<sup>17</sup> Shih nenin 37, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 20 shkurt 2008.

komunave do të shkarkohen nga detyra pas shqiptimit të dënimit për kryerje të veprës penale me urdhër për burgim për gjashtë muaj apo më tepër.<sup>18</sup>

### **3. SHQETËSIMET LIDHUR ME REAGIMET PËR MOSDEKLARIMIN E PASURISË NË KOHË**

#### **3.1 Vërejtjet e përgjithshme lidhur me interpretimin e ligjit nga autoritetet përgjegjëse**

Monitorimi dhe vlerësimi i OSBE-së i rasteve të deklarimit të pasurisë nga viti 2013 dhe 2014<sup>19</sup> flet për një keqinterpretim të mundshëm të nenit 437(1) që ka rezultuar me më shumë raste penale për mosdeklarim të pasurisë të ngritura dhe të proceduara se sa do të duhej duke pasur parasysh faktet themelore. Ky keqinterpretim duket të ketë buruar nga dështimi i personave gjegjë të përfshirë në këto raste të kuptojnë nenin 437(1) brenda kontekstit të kornizës së zgjeruar ligjore të Kosovës.

##### *3.1.1 Kërkesat e elementit material dhe të vetëdijes në kontekstin e Kodit Penal dhe Ligjin për deklarimin e pasurisë*

Siç u tha më sipër, Kodi Penal kërkon që mosdeklarimi i pasurisë të jetë i qëllimshëm, e kjo ndodh ose kur zyrtari i lartë publik është i vetëdijshëm për veprën dhe e dëshiron kryerjen e saj, ose kur zyrtari i lartë publik është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë nga veprimi i kundërligjshëm e megjithatë e lejon të ndodh. Pra, dija apo mosdija e zyrtarit të lartë publik është komponentë kritike për të provuar kryerjen e krimit.

Shqyrtimi i OSBE-së i kallëzimeve penale të Agjencisë Kundër Korrupsionit, aktakuzat e ngritura nga prokuroritë, vendimet gjyqësore për kërkesat për hedhje poshtë të aktakuzave, si dhe aktgjykimet nuk tregojnë se, nga faktet e prezantuara, nuk ka pasur interpretim konsistent përkitazi me atë se kur dhe nëse ka pasur dijeni nga ana e zyrtarëve publikë për përgjegjësinë e tyre për deklarimin e pasurisë. Në disa raste, njoftimi nga zyrtari kontaktues i shërbente autoriteteve gjegjëse si bazë për të supozuar se zyrtari publik ka qenë në dijeni për përgjegjësinë e tij/saj. Katër nga shtatë kallëzime penale, shtatë nga 21 aktakuza dhe tre nga 20 aktgjykimet të shqyrtuara nga OSBE përmendin rolin e zyrtarit kontaktues në informimin e zyrtarëve të lartë publikë, ku nuk është vërejtur praktikë e njëtrajtshme brenda dhe ndërmjet rajoneve. Në raste të tjera, autoritetet supozuan që zyrtari i lartë publik ishte i vetëdijshëm për obligimin për të dorëzuar deklaratë me vetë faktin se Agjencia Kundër Korrupsionit kishte publikuar informata të përgjithshme për obligimin e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pasurinë. Në tre nga shtatë rastet e kallëzimeve penale, gjashtë nga 21 aktakuza të ngritura, si dhe një nga katër vendimet për kërkesa për hedhje poshtë të aktakuzës iu referuan fushatave mediatike të Agjencisë Kundër Korrupsionit si bazë për dijeni, por nuk kishte praktikë të njëtrajtshme brenda dhe ndërmjet shtatë rajoneve prokuroriale dhe gjykatave themelore në Kosovë. Për më tepër, në të tjera raste të shqyrtuara nga OSBE-ja, duket se nuk është bërë asnjë analizë me përgjegjësi penale; shtatë nga 21 aktakuzat e ngritura, tre nga katër kërkesat për hedhje poshtë të aktakuzës dhe 17 nga 20 aktgjykimet nuk kanë përmendur as fushatat mediale as rolin e zyrtarit kontaktues, dhe nuk është vërejtur një praktikë e njëtrajtshme brenda dhe ndërmjet rajoneve.

---

<sup>18</sup> *Po aty*, neni 63.

<sup>19</sup> Bazuar në administrimin e 162 rasteve të shqyrtuara, analizën e hollësishme të 52 rasteve dhe respondentëve në mesin e autoriteteve relevante.

Siç u tha më sipër, neni 437(1) duhet të interpretohet në kontekst më të gjerë si të Kodit Penal ashtu edhe të Ligjit për deklarimin e pasurisë. Ligji për deklarimin e pasurisë përcakton caktimin e personit kontaktues në institucione relevante. Përgjegjësitë e personit kontaktues përfshijnë, mes tjerash, njoftimin e zyrtarëve të lartë publikë për obligimin e këtyre të fundit për të dorëzuar deklarata të pasurisë. Prandaj, me këtë ligj nënkuptohet që zyrtarët e lartë publikë nuk duhet të mbahen përgjegjës sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë si pasojë e mosdeklarimit të pasurisë nëse ata nuk janë njoftuar nga zyrtari kontaktues.

Neni 2(3) i Kodit Penal, përcakton që “në rast të paqartësive, përkufizimi i veprës penale do të interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.”<sup>20</sup> Kodi Penal përgjithësisht zbaton një standard shumë më të gjerë të dijenisë si element i veprës penale.<sup>21</sup> Prandaj, në këtë rast, standardi më i ngushtë dhe më i favorshëm në Ligjin për deklarimin e pasurisë – që kërkon njoftim nga zyrtari kontaktues – me shumë gjasë mbizotëron mbi tjetrin.<sup>22</sup>

Ky interpretim mbështetet fuqishëm në aspektin praktik, në veçanti sa i përket atyre të cilëve ju kërkohet për herë të parë deklarimi i pasurisë pas marrjes së detyrës së re si zyrtarë të lartë publikë. Në mënyrë të arsyeshme, mund të argumentohet që njoftimi i personalizuar, me të cilin zyrtari i lartë publik informohet që roli i lartpërmendur i nënshtrohet Ligjit për deklarimin e pasurisë, është mënyra kryesore – për të mos thënë e vetmja – për të garantuar njoftimin si duhet të zyrtarit të ri të lartë publik.<sup>23</sup> Që këtej, është i mundshëm konkluzioni që elementet materiale të krimit nuk janë përmbushur për shkak se njoftimi në fjalë nuk është bërë. Veç kësaj, në mungesë të provave të tjera, mund të argumentohet që vetëm për shkak se Agjencia Kundër Korrupsionit ka bërë njoftim të përgjithshëm publik për obligimin e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pasurinë nuk duhet të sjellë në konkludim se ka pasur qëllim kriminal.

Në veçanti, OSBE ka vërejtur praktika që shkojnë në pajtim me këtë interpretim në dy nga 52 rastet që i ka shqyrtuar. Në një rast ku përfshihej një zyrtar i lartë i komunës së Mitrovicës së Jugut, Gjykata Themelore e Mitrovicës e shpalli të pandehurin të pafajshëm në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ngaqë prokuroria nuk qe në gjendje të paraqiste asnjë provë që i pandehuri

<sup>20</sup> Shih nenin 2(3), Kodi Penal, *shënimi i mësipërm* **2Error! Bookmark not defined.**

<sup>21</sup> *Po aty*, neni 22 (“Dijenja...si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike”).

<sup>22</sup> Ndonëse i takon jurisprudencës dhe përfundimisht Gjykatës Supreme të Kosovës që t’i adresojë dhe qartësojë pyetjet lidhur me çështjet që sillen rreth elementit material të një vepre specifike penale nga njëra anë dhe ato që lidhen me elementin e vetëdijes nga ana tjetër – mbi të gjitha, kur ato duken të dyfishohen – ajo që është e rëndësishme për qëllim të këtij raporti është se, pavarësisht nga teoria e krimit, konkluzionet procedural do të jenë të njëjta: Zyrtarë të lartë publikë të cilët nuk ishin informuar si duhet për obligimin e tyre për deklarim të pasurisë duhet të kursehen nga përgjegjësia penale, posaçërisht kur kanë munguar të gjitha kushtet për informimin e duhur të tyre për shkak të mangësive strukturore brenda kornizës institucionale të Kosovës.

<sup>23</sup> Ligji për deklarimin e pasurisë nuk zbatohet për publikun e përgjithshëm, por për një pjesë të vogël të shoqërisë. Personi i nënshtrohet këtij ligji vetëm pas marrjes së pozitës së zyrtarit të lartë publik. Për disa arsye, njoftimi i përgjithshëm publik me gjasë është i pamjaftueshëm për të njoftuar zyrtarët e ri të lartë publikë së roli i tyre klasifikohet i tillë që kërkon deklarim të pasurisë. Për shembull, lista e roleve të zyrtarëve të lartë publikë në Ligjin e deklarimit të pasurisë përfshinë disa përshkrime të përgjithshme të punës (për shembull, “menaxhues të agjencive”, “drejtorë të të gjithë departamenteve, kryesues të financave publike dhe prokurimit të të gjitha institucioneve publike”). Këto mund të mos përkohet plotësisht me titullin e saktë që mbajnë këta zyrtarë. Veç kësaj, ka mospërputhje ndërmjet versioneve gjuhësore të Ligjit për deklarim të pasurisë, gjegjësisht ndërmjet versionit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze përkitazi se kush në kuvend komunal është i obliguar të deklarojë pasurinë, që e shton konfuzionin lidhur me atë se a i kërkohet një deklarim i tillë anëtarëve të kuvendeve komunale. Në versionin në gjuhën serbe të Ligjit për deklarimin e pasurisë neni 1.1.8 i përkufizon brenda atyre që duhet të deklarohen në nivel komunal edhe, si vijon: “Savetnike Opštinskih Asambleja”. Kjo përkthehet tekstualisht si “këshilltarët” e jo anëtarët e kuvendeve komunale. Për më tepër, versioni në gjuhën angleze i Ligjit (që nuk është version zyrtar) nuk i përmend këshilltarët ose anëtarët e kuvendeve komunale.



ishite njoftuar nga zyrtari kontaktues për sa i përket përgjegjësisë së tij për ta raportuar pasurinë. Ngjashëm, në një rast tjetër në Prokurorinë e Prishtinës, prokurori hodhi poshtë kallëzimin penal të bërë ndaj një këshilltari të Kuvendit komunal Leposavić/Leposaviqit për mungesë provash lidhur me njoftimin nga ana e zyrtarit kontaktues.

### *3.1.2 Detyrimi për deklarimin e pasurisë në kontekstin e Kodit Penal dhe Ligjit për deklarimin e pasurisë*

Në fund të tetorit 2015, OSBE-ja vuri në dukje se në kallëzimet penale, hedhjet poshtë, rastet ose aktakuzat që i kishte shqyrtuar as Agjencia Kundër Korrupsionit dhe as prokuroria nuk i kishin trajtuar implikimet e përgjegjësisë penale në rastet kur zyrtari i ka dhënë deklaratën një personi, që konsiderohej të ishte person i autorizuar, por i cili person ka dështuar më pas ta dorëzojë deklaratën tek Agjencia Kundër Korrupsionit. Kjo situatë duket të ketë ndodhur në të paktën në një komunë, atë të Leposavić/Leposaviqit, dhe t'i ketë prekur të gjithë këshilltarët e kuvendit komunale atje, pas së cilës rrjedhimisht janë ngritur kallëzimet penale dhe aktakuzat.<sup>24</sup>

Megjithatë, sipas Kodit Penal, nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi penale në rastet kur ka pasur gabime faktike ose ligjore, dhe Ligji për deklarimin e pasurisë ia lejon zyrtarit të lartë publik që deklaratën e pasurisë ta dorëzojë ose përmes një personi të autorizuar, ose përmes personit që konsiderohet të jetë person i autorizuar. Kështu, me gjasë nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi penale në rastet kur zyrtari i lartë publik ia përcjellë deklaratën e pasurisë një personi të autorizuar, me supozimin që në këtë mënyrë ai ka vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për deklarimin e pasurisë dhe pastaj ky person nuk e dorëzon deklaratën në vendin e duhur.<sup>25</sup>

## **3.2 Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kundër Korrupsionit**

### *3.2.1 Verifikimi nëse zyrtarët janë njoftuar nga zyrtari kontaktues*

Në katër nga shtatë kallëzimet penale të shqyrtuara të cilat janë ngritur nga Agjencia Kundër Korrupsionit, të gjitha të vitit 2014 dhe ku përfshiheshin këshilltarë të kuvendit të komunës të Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka siguruar informata për atë nëse zyrtari i lartë publik ishte njoftuar nga zyrtari kontaktues apo jo. Ndryshe, në katër kallëzime të tjera penale të shqyrtuara, të gjitha të ngritura në vitin 2013 dhe që kishin të bënin me këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit/Gnjilane, një pjesëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe një deputet të Kuvendit të Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte bërë referencë në rolin e zyrtarit kontaktues.

Në mars të vitit 2015, Agjencia Kundër Korrupsionit botoi një doracak për zyrtarët kontaktues, me të cilin zyrtarët kontaktues informohen në mënyrë specifike përkitazi me detyrën e tyre për ta njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publikë për përgjegjësinë e tyre për ta deklaruar pasurinë, si dhe detyrën për të dokumentuar njoftimet e bëra në rast të paraqitjes së nevojës për to në të ardhmen. Megjithatë, në një intervistë me zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit të realizuar në fund të muajit mars të vitit 2015 është parë që, asokohe, Agjencia Kundër Korrupsionit vazhdonte të

<sup>24</sup> Shih Pjesën 3.5 më poshtë. Në këto raste, kallëzimet u hodhën poshtë pasi që prokuroria konstatoi se zyrtarët në fjalë ende nuk e kishin bërë betimin me rastin e marrjes së detyrës si zyrtar i lartë publik sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin për deklarimin e pasurisë.

<sup>25</sup> I vetmi përjashtim do të ishte nëse do të mund të provohej se personi, në përpjekje që të mbrohet nga përgjegjësia penale, e ka udhëzuar përfaqësuesin e autorizuar që të mos e paraqesë deklaratën.

ishte e mendimit se njoftimi nëpërmjet një fushate mediale mund të përbënte bazë të mjaftueshme për të ngritur kallëzim penal.

Si rezultat, është e pamundur të përcaktohet nëse prej janarit të vitit 2013 deri në tetor të vitit 2015 Agjencia Kundër Korrupsionit ka zbatuar ndonjë politikë të njëtrajtshme lidhur me domosdoshmërinë e njoftimit nga ana e zyrtarëve kontaktues, si parakusht për ngritje të kallëzimit penal. Për aq sa udhëzimi i botuar rishtas përcakton një politikë të re në këtë drejtim, OSBE-ja e mirëpret këtë zhvillim dhe inkurajon Agjencinë Kundër Korrupsionit që të sigurojë zbatimin në mënyrë të njëtrajtshme, duke ngritur kallëzime penale vetëm pasi që të vërtetohet se zyrtari kontaktues e ka njoftuar drejtpërdrejt zyrtarin e lartë publik përkatës përkitazi me përgjegjësinë e këtij të fundit për ta deklaruar pasurinë.<sup>26</sup> Për më tepër, OSBE-ja sugjeron që Agjencia Kundër Korrupsionit ta zyrtarizojë në mënyrë specifike sistemin ku zyrtarët e lartë publikë duhet ta nënshkruajnë një njoftim me shkrim për obligimin e tyre për ta deklaruar pasurinë, si pjesë e pakos së ofruar nga zyra e personelit me rastin e marrjes së detyrës. Kjo do t'ia lehtësonte prokurorisë në masë të madhe barrën e shqyrtimit të asaj se çfarë ka bërë apo nuk ka bërë zyrtari kontaktues në secilin rast dhe do të shërbente si verifikim fillestar nga ana e Agjencisë Kundër Korrupsionit për atë se cilat raste ngritin dyshime të arsyeshme për sjellje të kundërligjshme e cilat jo.

### 3.2.2 Ngritja me automatizëm e kallëzimeve penale për mosdeklarim të pasurisë

Sipas zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit, është praktikë e Agjencisë që të ngrisë kallëzim penal sa herë që një zyrtar i lartë publik nuk deklaron pasurinë në kohë. Në prill të vitit 2014, Ligji për deklarimin e pasurisë u ndryshua dhe plotësua për ta përfshirë penalizimin e mosdeklarimit të pasurisë, e që ishte paraparë me Kodin Penal në janar të vitit 2013.<sup>27</sup> Versioni paraprak i ligjit i jepte Agjencisë Kundër Korrupsionit kompetencën për të shqiptuar sanksione administrative kundër zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e deklarorin pasurinë. Me ndryshimet e plotësimet e muajit prill të vitit 2014, Agjencisë Kundër Korrupsionit iu dha kompetencë e re për të “paraqitur kallëzim penal në prokurorinë kompetente ndaj zyrtarit të lartë publik i cili shkel detyrimet e parashikuara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit penal.”<sup>28</sup>

Në një intervistë të realizuar me zyrtarë të Agjencisë Kundër Korrupsionit, zyrtarët treguan se ishin të mendimit se kjo dispozitë parasheh që Agjencia Kundër Korrupsionit të paraqesë kallëzim penal për secilin rast të mosdeklarimit të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik. Gjithashtu, zyrtarët shprehën frustrimin e tyre që ky ndryshim ia kishte hequr Agjencisë mundësinë e përdorimit të sanksioneve administrative si mënyrë për t'i shtyrë zyrtarët e lartë publik që ta korrigjojnë mosdeklarimin.

Megjithatë, ky duket të jetë interpretim shumë i ngushtë i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për deklarimin e pasurisë. Interpretim më i arsyeshëm mund të jetë që Ligji parasheh që Agjencia Kundër Korrupsionit të bëjë kallëzim penal vetëm pasi të ketë konstatuar fillimisht se ekziston dyshimi i arsyeshëm se vepra penale është kryer, më te dyja elementet e saj, material dhe të vetëdijes (me fjalë tjera, që zyrtari i lartë publik nuk e ka deklaruar qëllimisht pasurinë). Pikërisht kjo do t'i jepte mundësi Agjencisë Kundër Korrupsionit që zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë t'ju japë një mundësi tjetër për ta bërë këtë, si dhe t'ua bëjë të ditur se nëse nuk e bëjnë këtë Agjencia mund të bëjë kallëzim ndaj tyre. Megjithatë, Ministria e

<sup>26</sup> Shih Pjesën 3.2.2 më poshtë.

<sup>27</sup> Shënim 1 më sipër.

<sup>28</sup> Shin nenin 17(1), Ligji për deklarimin e pasurisë, shënimi 1 më sipër.

Drejtësisë mund të ketë dëshirë të rishqyrtojë zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të prillit 2014 në Ligjin për deklarimin e pasurisë për të parë nëse po i përmbushin qëllimet për të cilat janë miratuar, në përputhje me *Udhërrëfyesin për vlerësimin ex-post të legjislacionit*, që me vendim të Qeverisë të korrikut 2015 është i detyrueshëm për të gjitha agjencitë qeveritare dhe ministritë.<sup>29</sup>

### 3.2.3 *Caktimi dhe trajnimi efektiv i zyrtarëve kontaktues*

OSBE ka vërejtur se në shkurt të vitit 2014 Agjencia Kundër Korrupsionit ka filluar t'i trajnojë zyrtarët kontaktues për sa u përket detyrave dhe përgjegjësive të tyre, ndërsa në mars të vitit 2015 ka publikuar një doracak të hollësishëm të cekur më lartë. Këto janë shumë zhvillime pozitive për të cilat duhet përgëzuar Agjencinë Kundër Korrupsionit. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se para shkurtit të vitit 2014 mbështetja e tillë sistematike ka munguar. Në tre nga shtatë kallëzimet penale që datojnë para shkurtit të vitit 2014 të cilat i ka shqyrtuar OSBE-ja, nuk përmendet askund detyra e zyrtarit kontaktues për ta njoftuar zyrtarin e lartë publik përkatës. Kështu, është e diskutueshme nëse zyrtarët kontaktues kanë qenë plotësisht funksional në gjithë Kosovën para kësaj date, dhe monitorimi i OSBE-së ka shpalosur që, në të vërtetë, deri në shkurt të vitit 2014, të paktën tri komuna ende nuk i kishin caktuar në mënyrë efektive zyrtarët kontaktues.<sup>30</sup>

## 3.3 Çështjet lidhur me ndjekjen penale

### 3.3.1 *Veprime të ndryshme pas pranimit të kallëzimit penal*

Prej 162 kallëzimeve penale të bëra nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe të pranuar nga prokuroria prej vitit 2013 deri në vitin 2014, 117 janë zgjidhur deri në fund të qershorit 2015, ndërsa 45 janë ende në prokurori. 117 kallëzime penale u zgjidhën nga prokuroria si në vijim: pesë kallëzime penale (4%) u hodhën poshtë pa u ndërmarrë hapa të mëtejme; 16 (14 %) u hodhën poshtë pas mbarimit të hetimeve; për 59 (50%) raste është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve; 32 (27%) raste është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejt; dhe për pesë (4%) raste është kërkuar urdhër ndëshkimor.<sup>31</sup>

Derisa OSBE nuk ka analizuar nëse vendimet për secilin rast kanë qenë të justifikuara, divergjenca midis rezultateve duket të jetë tregues i mungesës së njëtrajtshmërisë në praktikën prokuroriale, meqë rastet e mosraportimit të pasurisë nuk është se kanë ndryshueshmëri të mëdha për sa i përket fakteve. Përkundrazi, duket se prokurorët nëpër prokurori të ndryshme në Kosovë i trajtojnë rastet e mosraportimit të pasurisë në mënyra të ndryshme në varësi të mënyrës se si e interpretojnë ata ligjin dhe ngarkesës me lëndë, duke çuar në rezultate krejtësisht të ndryshme pavarësisht ngjashmërisë së madhe mes këtyre llojeve rasteve. Kjo përbën brengë lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtës për barazi para ligjit të garantuar nga kuadri ligjor i Kosovës.

Në qershor të vitit 2015, me mbështetjen e OSBE-së, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit mbajti një punëtori me qëllim të analizimit të praktikave të ndryshme të prokurorive në Kosovë dhe në

<sup>29</sup> Shih Vendimin nr. 03/38, 15 korrik 2015. Udhërrëfyesit për vlerësimin ex-post të legjislacionit është në dispozicion në [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/2\\_Guidelines\\_on\\_Ex-post\\_evaluation.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/2_Guidelines_on_Ex-post_evaluation.pdf)

<sup>30</sup> Shih Pjesën 3.5 më poshtë (ku shtjellohen komunat në të cilat zyrtarët kontaktues duket të mos kenë qenë të caktuar para afatit të fundit për deklarimin e pasurisë).

<sup>31</sup> Siç u shtjellua më sipër, të dhënat të cilat i ka pranuar OSBE nuk janë të klasifikuara në raste të mosdeklarimit të pasurisë sipas nenit 437(1) të Kodit penal dhe në raste të deklarimit të pasaktë sipas nenit 437(2). Shih Pjesën 1 sipër. Prandaj, këto informata janë lidhur me të dy llojet e rasteve.

përpjekje të harmonizimit të këtyre praktikave. Këto përpjekje janë për tu përgëzuar. Angazhimi për njësimin e praktikave të prokurorive të Kosovës në këto raste, pa anashkaluar nevojën për ta trajtuar secilin rast në bazë të meritave që ka, janë vendimtare për të siguruar zbatimin efektiv të standardeve të sundimit të ligjit të përfshira në kornizën ligjore të Kosovës. Për këtë qëllim, OSBE ka vërejtur që, sipas kompetencave të reja të parapara me ndryshimet dhe plotësimet që i janë bërë rishtas Ligjit për Prokurorin e Shtetit, Kryeprokurori i Shtetit tani mund të nxjerrë udhëzime dhe vendime të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të harmonizimit të praktikave prokuroriale.<sup>32</sup>

### 3.3.2 Përdorimi jo i duhur i aktakuzave të drejtpërdrejta

Në pesë nga 52 rastet e shqyrtuara nga OSBE, ku ishin përfshirë tre anëtarë të Kuvendit të Komunës së Leposavić/Leposaviqit, një deputet i Kuvendit të Kosovës, dhe një administrator i Komunës së Mitrovica/Mitrovicës së veriut, pas pranimit të kallëzimit penal, prokuroria, në vend se t'i fillonte hetimet, kishte ngritur menjëherë aktakuzë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, aktakuzat e drejtpërdrejta duket të mos kenë qenë të bazuara në asnjërin nga rastet në fjalë, qoftë sepse nuk ishin të arsyetuara mirë ose sepse nuk jepnin shpjegime të mjaftueshme për elementin e vetëdijes për veprën penale të kryer.<sup>33</sup>

Kodi i procedurës penale<sup>34</sup> parasheh që prokurori, pas pranimit të kallëzimit, ka dy opsione përveç hedhjes së menjëhershme poshtë të tij: (1) nëse ekziston dyshimi i arsyeshem për një veprë, të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale; ose (2) nëse ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer një veprë penale ose disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me gjobë dhe/ose me më shumë se tre vjet burgim, të ngritë aktakuzë të drejtpërdrejtë sipas nenit 241 të Kodit të procedurës penale,

Duke qenë se vepra penale e mosraportimit të pasurisë dënohet me burgim deri në tre vjet, prokurori ka të drejtën që në këto raste të ngritë aktakuzë të drejtpërdrejtë kur ka prova që ngritin dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprë penale. Sidoqoftë, aktakuzat e drejtpërdrejta duhet të shoqërohen me prova që tregojnë dyshimin e bazuar e prokurorit, i cili duhet të përfshijë referencë për elementin e dijenisë për veprën penale. Në qoftë se kallëzimet penale të bëra nga Agjencia Kundër Korrupsionit nuk përmbajnë në masë të kënaqshme informacione rreth ekzistencës së dyshimit të bazuar mirë, e që është standard i domosdoshëm për ngritje të aktakuzës, për të gjithë elementët material dhe të vetëdijes të veprës për të cilën duhet të akuzohet zyrtari i lartë publik, atëherë duhet të inkurajohet zhvillimi i hetimeve. Në këtë kuptim, ndër çështjet që duhen marrë në konsideratë është edhe roli i zyrtarit kontaktues për ta njoftuar zyrtarin e lartë publik.

### 3.3.3 Aktakuzat me arsyetime të mangëta

Pavarësisht nëse janë zhvilluar hetime apo jo, vetëm katër nga 21 aktakuzat e shqyrtuara nga OSBE duket të përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm. 17 aktakuzat tjera të ngritura ndaj anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut, Mitrovica/Mitrovicës së veriut dhe Mitrovicës/Mitrovica së jugut, një deputeti të Kuvendit të Kosovës, një anëtar i të

<sup>32</sup> Ligji nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, neni 11(1.5), 28 maj 2015.

<sup>33</sup> Në tri prej aktakuzave në fjalë ishte përmendur roli i zyrtarit kontaktues (një rast) ose fushata mediale e Agjencisë kundër Korrupsionit (dy raste), dhe asnjëra aktakuzë nuk dukej të ishte e arsyetuar mirë.

<sup>34</sup> Shih nenin 101, Kodi nr. 04/L-123 i procedurës penale (Kodi i procedurës penale), 1 janar 2013.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe një administratori në Policinë e Kosovës nuk përmbanin hollësi të tjera përveç informatave të përgjithshme të paraqitura në kallëzimet e bëra nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe/ose nuk përmbanin analizë të duhur të fakteve në kontekstin e ligjit. Për shembull, aktakuzat e shqyrtuara nga OSBE-ja nuk përmbanin informata nëse zyrtari kontaktues ishte caktuar dhe, nëse po, nëse zyrtari kontaktues e kishte njoftuar zyrtarin e lartë publik përkatës në mënyrën e duhur. Përkundrazi, këto aktakuzat thjesht thoshin se në shkresat e lëndës kishte prova të mjaftueshme për të konstatuar se elementet e veprës penale janë përmbushur, por nuk jepnin as arsyetim ligjor as arsyetim faktik në mbështetje të konkluzioneve të tilla. Për më tepër, madje edhe atëherë kur të pandehurit kishin paraqitur prova shfajësuese gjatë fazës së hetimit si, për shembull, se ata nuk ishin njoftuar nga zyrtari kontaktues ose ishin përprjekur që deklarimin ta bënin përmes një përfaqësuesi të autorizuar i cili nuk ia kishte përcjellë deklaratën Agjencisë Kundër Korrupsionit, aktakuzat e shqyrtuara nuk i merrnin në konsideratë këto prova. Përkundrazi, provat vetëm se ishin renditur në aktakuzë pa u analizuar, dhe argumentet e paraqitura nga të pandehurit nuk ishin adresuar, por thjesht ishin hedhur poshtë si të pabazuara. Aktakuzat e shqyrtuara nga OSBE duket të jenë në kundërshti me nenin 241 (1.7) të Kodit të procedurës penale, ku parashihet që të gjitha aktakuzat të përmbajnë "shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore".

### 3.3.4 Mospërdorimi i alternativave

Prokurorët nuk e kanë përdorur asnjërin nga alternativat e parapara me Kodin e procedurës penale në asnjërin nga rastet e monitoruara apo të shqyrtuara nga OSBE-ja. Disa alternativa janë të parapara në kapitullin XIV të Kodit të Procedurës Penale, si mjete për t'i adresuar rastet para se të shkojnë në gjykatë. Së pari, prokurorët mund të pezullojnë ndjekjen për veprën penale (me pëlqimin e palës së dëmtuar) nëse plotësohen kushte të caktuara dhe nëse i pandehuri zotohet se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale.<sup>35</sup> Së dyti, prokurorët mund të heqin dorë nga ndjekja në disa kushte kur ndjekja penale nuk është e detyrueshme.<sup>36</sup> Për shembull, mund të hiqet dorë nga ndjekja nëse kryerësi i veprës penale tregon pendim të sinqertë për veprën penale dhe ndalon pasojat e dëmshme ose bën kompensimin e dëmit, kurse prokurori vlerëson se nga aspekti i rrethanave aktuale të çështjes ndëshkimi penal nuk do të ishte i arsyeshëm. Së treti, prokurori mund ta dërgojë çështjen në ndërmjetësim.<sup>37</sup> Së katërti, prokurori mund t'i negociojë kushtet e marrëveshjes me shkrim për pranimin e fajësisë.<sup>38</sup>

Rastet e mosraportimit të pasurisë duket të jenë ideale për përdorimin e alternativave në vend të procedurës penale, në veçanti kur provat e paraqitura nga Agjencia Kundër Korrupsionit janë të kufizuara. Për shembull, prokurorët do të mund t'i udhëzonin të pandehurit që ta deklarojnë pasurinë brenda një afati kohor të caktuar, duke ua bërë me dije se kallëzimi do të hidhet poshtë nëse ata deklarojnë pasurinë, e nëse nuk e bëjnë do të ngritet aktakuzë. Kjo qasje do të ishte e dobishme për përcaktimin e elementit të dashjes për ata që nuk e deklarojnë pasurinë edhe pasi janë udhëzuar për këtë gjë nga prokuroria, derisa çështja zgjidhet menjëherë për ata që bëjnë deklarinë. Për më tepër, përdorimi i alternativave të tilla do t'u lejonte prokurorëve që përprjekjet e tyre t'i përqendrojnë në rastet ku elementi i dashjes ekziston qartazi.

<sup>35</sup> Shih nenin 230, Kodi i procedurës penale, shënimi 34 më sipër.

<sup>36</sup> *Po aty*, neni 231.

<sup>37</sup> *Po aty*, neni 232.

<sup>38</sup> *Po aty*, neni 233.

Në këtë drejtim, OSBE nënvizon përpjekjet shumë të lavdërueshme të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për ta rritur përdorimin e këtyre alternativave në tërë Kosovën; prej muajit gusht gjer në muajin shtator të vitit 2015, Zyra ka mbajtur një sërë trajnimesh me mbështetjen e OSBE-së për të gjitha prokuroritë për përdorimin e procedurave të tilla. Kështu, mungesa e trajnimit, që prokurorët ia kishin përmendur OSBE-së si arsye kryesore për mospërdorimin e këtyre alternativave, është adresuar.

### **3.4 Çështjet që kanë të bëjnë me gjykatat**

#### *3.4.1 Mosverifikimi nëse të pandehurit ishin vënë në dijeni nga zyrtari kontaktues për detyrimin për ta deklaruar pasurinë*

Nga 52 rastet e përzgjedhura, OSBE i ka shqyrtuar katër vendime gjyqësore mbi kërkesat për hedhje poshtë të aktakuzës dhe 20 aktgjykime që mbulonin një mostër gjithëpërfshirëse të zyrtarëve të lartë publik: këshilltarë të kuvendeve komunale të Gjakovës/Dakovica, Gjilanit/Gnjilane, Leposavić/Leposaviqit, Mitrovicës/Mitrovica së Jugut, Mitrovica/ Mitrovicës së veriut dhe Skenderajt/Srbica; deputetë të Kuvendit të Kosovës; administratorë në Policinë e Kosovës dhe Komunën e Mitrovicës së Jugut; prokurorë nga Gjakova/Dakovica dhe Prishtina/Priština; një gjyqtar nga Gjilani/Gnjilane; dhe dy zëvendëskryetarët e Komunës së Gjilanit/Gnjilane. Me përjashtim të vetëm katër rasteve, ku ishin të përfshirë një anëtar i Kuvendit të Komunës së Gjilanit/Gnjilane, një anëtar i Kuvendit të Komunës së Leposavic/Leposaviqit, një administrator i Komunës së Mitrovicës/Mitrovica së jugut, dhe një nga zëvendëskryetarët e Komunës së Gjilanit/Gnjilane, gjykatat nuk verifikuan nëse zyrtari i lartë publik ishte njoftuar nga ana e zyrtarit kontaktues në mënyrën e duhur. Në këto 20 vendime dhe aktgjykime të shqyrtuara, OSBE-ja ka vërejtur se nuk janë dhënë arsyetime të mjaftueshme për t'i mbështetur konstatimet në favor të ndjekjes. Kjo vlen edhe për ato raste ku të pandehurit kishin dhënë argumentin se ata mund të kenë përgjegjësi penale sepse nuk kishin qenë të njoftuar si duhet për detyrimin e tyre për ta deklaruar pasurinë. Madje edhe në këto raste, gjykatat nuk arritën t'i trajtojnë argumentet e të pandehurve në mënyrë të duhur.

Si shembull, në rastin e dy aktgjykimeve të shqyrtuara nga OSBE, të pandehurit u deklaruan fajtorë dhe gjykata e pranoi pranimin e fajësisë duke deklaruar se ishte i mbështetur nga provat që gjendeshin në shkresat e lëndës, ndonëse në të dyja rastet nuk kishte asnjë provë lidhur me bërjen e njoftimit përveçse shpalljet publike të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në këto raste, gjykatat arritën në përfundimin se, në dritën e provave të paraqitura, elementet e veprës penale ishin provuar përtej dyshimit të arsyeshëm, por pa vazhduar me dhënien e arsytimit për ta mbështetur këtë përfundim.

Ngjashëm, në dy vendime të nxjerra në fazën e aktakuzës të cilat i ka shqyrtuar OSBE-ja, gjykata i refuzoi kërkesat e të pandehurve për hedhje poshtë të aktakuzës edhe pse aktakuzat nuk përmbanin asgjë tjetër përveç referencës në njoftimet publike të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në njërin prej këtyre vendimeve, gjykata kishte arritur në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, por nuk ishte dhënë asnjë arsyetim. Vendimi u vërtetua në apel. Në rastin tjetër, gjykata e kishte kthyer gabimisht barrën e provës; në vend se të verifikonte nëse prokurori kishte paraqitur prova të mjaftueshme në aktakuzë apo jo, ajo kishte verifikuar nëse i pandehuri e kishte bërë këtë në kërkesën e tij për hedhjen e aktakuzës. Në kërkesën e tij, i pandehuri kishte shpjeguar se kishte qenë në dijeni që është dashur të paraqesë një deklaratë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe për këtë arsye ua kishte dorëzuar atë zyrtarëve komunalë në komunën e tij (domethënë, dikujt i

cili konsiderohet të jetë "person i autorizuar"). Gjykata konsideroi se ai nuk e kishte provuar këtë fakt dhe konfirmoi aktakuzën.

Kështu, në këto raste, gjykatat jo vetëm që nuk arritën të shqyrtojnë nëse të pandehurit ishin njoftuar për detyrimin për ta bërë deklarinin përmes Zyrtarit Kontaktues por përgjithësisht dështuan në arritjen e konkluzioneve që mbështeteshin me arsyetime adekuate. Megjithatë, pavarësisht këtyre mangësive, OSBE-ja nuk arriti të gjejë një rast të vetëm ku Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë një vendim apo gjykim për mungesë të arsytimit.

Është thelbësore që gjykatat të identifikojnë qartas se cilat janë elementet e veprës penale para së të analizohen faktet. Shembull mund të jetë një rast kundër një zyrtari në Prizren, që është vëzhguar nga OSBE-ja. Në këtë rast, gjykata hodhi poshtë aktakuzën pas propozimit për ta hedhur poshtë nga i pandehuri, për shkak të mungesës së arsytimit. Gjatë hetimit, prokurori e kishte intervistuar të pandehurin dhe kishte përfshirë një përmbledhje të deklaratës së të pandehurit në aktakuzë. Megjithatë, aktakuza fare nuk kishte trajtuar argumentet e të pandehurit. Kështu, gjykata hodhi poshtë aktakuzën duke theksuar se provat e listuara në aktakuzë, që përfshinte deklaratën e të pandehurit, paraqisnin një situatë krejtësisht të ndryshme nga ajo që përshkruhej nga prokurori. OSBE-ja i bën thirrje gjykatave të tjera që të aplikojnë lloje të tilla të arsytimeve rigoroze për të gjitha rastet e deklaratave të pasurisë, qoftë në Gjykatë Themelore apo në fazën e apelit.

### *3.4.2 Dështimi për t'i mbrojtur të drejtat e të pandehurve të papërfaqësuar*

Siç u përmend më lart, 24 nga 52 rastet e shqyrtuara nga OSBE-ja kishin rezultuar në vendim mbi kërkesën për hedhje poshtë të aktakuzës ose aktgjykim deri në fund të tetorit 2015. Në 18 prej këtyre rasteve, të pandehurit nuk kishin përfaqësim nga avokati, qoftë privatisht qoftë të emëruar ose të caktuar me shpenzime publike. Të pandehurit kishin përfaqësim në vetëm gjashtë prej këtyre rasteve.

Rastet e deklarimit të pasurisë nuk kualifikohen për mbrojtje të detyrueshme penale pa pagesë<sup>39</sup>. Megjithatë, Kodi i Procedurës Penale lejon që të pandehurit të cilët nuk mund ta përballojnë koston e një avokati që të kërkojnë shfrytëzimin e mbrojtjes penale pa pagesë, e cila duhet të lëshohet nëse gjykata konstaton se këtë e kërkon interesi i drejtësisë<sup>40</sup>. Megjithatë, monitorimi i OSBE-së tregon se gjykatat nuk informojnë rregullisht të pandehurit e papërfaqësuar për të drejtën e tyre për të bërë një kërkesë të tillë.

Përveç kësaj, monitorimi i OSBE-së tregon se gjykatat nuk ushtrojnë kujdes shtesë për të siguruar barazi të armëve në rastet kur të pandehurit janë të papërfaqësuar, qoftë në aspektin e ofrimit të udhëzimeve për të pandehurit e papërfaqësuar, qoftë duke marrë parasysh mungesën e njohurive/edukimit ligjor të të pandehurve gjatë seancave. Përkundrazi, OSBE-ja ka vërejtur një numër të rasteve ku gjykatat kanë hedhur poshtë argumentet e të pandehurve të papërfaqësuar pa konsideratë adekuate, për shembull, se nuk janë njoftuar si duhet mbi detyrimet e tyre për të parashtruar një deklaratë.

Në anën tjetër, monitorimi i OSBE-së tregon rezultate të favorshme për të pandehurit që kanë përfaqësim në gjykatë. Nga gjashtë të pandehur të përfaqësuar me avokat në gjykatë, dy janë

<sup>39</sup> Shih nenet 57-58, Kodi i Procedurës Penale, shënimi më lartë 34 (në lidhje me rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe kur nuk janë përmbushur kushtet për mbrojtje të detyrueshme).

<sup>40</sup> *Po aty*, neni 58.

deklaruar fajtor dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen e fajësisë, një të pandehuri i është hedhur poshtë aktakuza, dhe tre janë liruar pas gjykimit. Kjo është ndryshe nga përfundimet e rasteve ku të pandehurit nuk ishin të përfaqësuar me avokat mbrojtës. OSBE-ja ka monitoruar 13 raste para gjykatave në të cilat i pandehuri nuk ishte i përfaqësuar dhe të cilat rezultuan në gjykim. Në ato raste, shtatë të pandehur u deklaruan fajtorë dhe gjykata pranoi marrëveshjen e fajësisë, dy të pandehur u shpallën fajtorë pas gjykimit, dhe katër të pandehur u liruan pas gjykimit.

Kontrasti midis dy rasteve të mëposhtme para gjykatës themelore në Mitrovicë mund të shërbejë për të nxjerrë në pah rëndësinë e përfaqësimit ligjor në këto raste dhe të kujdesit shtesë nga gjykata për të pandehurit e papërfaqësuar. Në rastin e parë, në të cilin i pandehuri kishte përfaqësues ligjor, një zyrtar i lartë publik në komunën e Mitrovicës/Mitrovica jugore pohoi në gjykim se nuk ishte njoftuar nga Zyrtari Kontaktues. Gjykata në këtë rast e liroi të pandehurin. Megjithatë, në rastin e dytë, ku i pandehuri nuk kishte përfaqësues ligjor, zyrtari i lartë publik në komunën e Mitrovica/Mitrovicës veriore u deklarua fajtor për pikat e aktakuzës, edhe pse provat në aktakuzë kishin të bënin vetëm me faktin se Agjencia Kundër Korrupsionit lëshoi një lajmërim publik dhe rrethanat lidhur me mosdeklarimin tregonin se nuk kishte qenë i emëruar Zyrtari Kontaktues në kohën zyrtari i lartë publik është kërkuar të deklarojë. Në këtë rast, në pranimin e fajësisë, gjykata nuk e shqyrtoi në thellësi nëse pranimi i fajësisë i të pandehurit është bazuar në një aktakuzë të bazuar. Gjithashtu, ndryshe nga gjykata në rastin e parë, kjo gjykatë nuk shqyrtoi nëse ekzistonte Zyrtari Kontakt dhe, nëse po, nëse Zyrtari Kontaktues kishte njoftuar Zyrtarin e Lartë Publik. Kështu, ndonëse faktet themelore në këto dy raste ishin shumë të ngjashme, ato rezultuan me përfundime krejtësisht të ndryshme, në masë të madhe duke favorizuar të pandehurin e përfaqësuar.

### **3.5 Rast ilustrues për studim**

Çështjet e ngritura më lartë mund të shihen ndryshe duke e shikuar një studim indikativ të rasteve të ngritura kundër këshilltarëve të rinj të kuvendeve të tri komunave të reja të themeluara. Në janar të vitit 2014, katër komuna të reja janë themeluar në pjesën veriore të Kosovës - Zubin Potok, Mitrovica/Mitrovicë veriore, Leposavic/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan – si rezultat i progresit të arritur në zbatimin e *“marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve”* të prillit 2013, të arritur në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Në tri këto komuna – Zubin Potok, Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq – shumica e këshilltarëve të kuvendeve komunale nuk kanë dorëzuar deklaratimet e tyre tek Agjencia Kundër Korrupsionit, brenda afatit 30-ditor të përcaktuar me ligj, duke rezultuar në ngritjen e 38 kallëzimeve penale (që përbën një pjesë të madhe të 162 kallëzimeve penale të përgjithshme të ngritura nga Agjencia Kundër Korrupsionit në periudhën 2013 dhe 2014). Këto raste janë veçuar për këtë raport, sepse rrethanat themelore të dështimeve në deklarim ishin kryesisht të njëjta, por megjithatë tiparet dhe rezultatet e rasteve ndërmjet tyre dhe rasteve të tjera të vëzhguara nga OSBE-ja dallojnë shumë, duke vënë në pah mungesën e njëtrajtshmërisë në praktikë që OSBE-ja ka vërejtur në të gjithë Kosovën.

Informatat e mbledhura nga OSBE-ja në lidhje me themelimin e këtyre komunave tregon se, në afatin e dorëzimit të deklaratave për këshilltarët e sapo-emëruar të kuvendeve komunale, këto tri komuna nuk kishin emëruar zyrtarisht zyrtarët përkatës kontaktues për t'i informuar këshilltarët lidhur me detyrimin e tyre për të deklaruar. Në të paktën dy komuna, Mitrovica/Mitrovicë veriore dhe Zubin Potok, nuk janë emëruar Zyrtarët Kontaktues. Në Leposaviq, këshilltarët e kuvendit komunal kishin dorëzuar deklaratat e tyre tek personat të cilët ata besonin se ishin duke



bashkërenduar dorëzimin e deklaratave, por deklaratat e tyre nuk janë përcjellë tutje në Agjencinë Kundër Korrupsionit<sup>41</sup>. Siç u diskutua më sipër<sup>42</sup>, në këtë kohë, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk kishte filluar me trajnime sistematike të Zyrtarëve Kontaktues dhe ende nuk kishte publikuar doracakun për zyrtarët kontaktues. Si rezultat, duket se Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka kryer kontakt të drejtpërdrejtë në terren me këshilltarët e veçantë të kuvendeve komunale.

Në vend të kësaj, më 13 janar 2014, Agjencia Kundër Korrupsionit lëshoi një njoftim të përgjithshëm për media, duke përkujtuar zyrtarët e tërë Kosovës për nevojën për të deklaruar. Lajmërimi në media dhe fakti që Agjencia Kundër Korrupsionit më pas nuk pranoi deklarata nga këshilltarët e kuvendit komunal në Zubin Potok, Mitrovicë veriore dhe Leposaviq krijoi bazën mbi të cilën Agjencia Kundër Korrupsionit ngriti kallëzime penale kundër 38 këshilltarëve të kuvendeve komunale. Rastet pastaj u ndanë në mes të prokurorive në Mitrovicë dhe Prishtinë<sup>43</sup>. Përkundër ngjashmërive vërejtura në këto raste, OSBE-ja ka parë trajtim të ndryshëm nga prokurorët dhe gjykatat.

Në fazën e prokurorisë, aktakuzë e drejtpërdrejtë është ngritur në tre raste – dy në Mitrovicë dhe një në Prishtinë – por një rast është hedhur poshtë menjëherë nga zyra e prokurorisë në Prishtinë, që tregon opinion të ndryshëm lidhur me atë nëse këto raste kanë përgjegjësi penale apo jo. Hetimet kanë filluar në 35 rastet e mbetura. Nga hetimet që kanë përfunduar në fund të muajit tetor 2015, tri u hodhën poshtë, të gjitha nga prokuroria Prishtinës, ndërsa tetë rezultuan me aktakuzat, tri në Prishtinë, pesë në Mitrovicë. Tre nga aktakuzat i referoheshin rolit të Zyrtarit Kontaktues për njoftimin e zyrtarëve të lartë publikë dhe lajmërimin publik të 13 janarit 2014, katër kanë referenca vetëm në lajmërimin publik të 13 janarit 2014, dhe një nga to nuk ka referenca të tilla fare.

Në gjykata, OSBE-ja i ka vërejtur tri vendime mbi kërkesat për t'i hedhur poshtë aktakuzat dhe një gjykim pas pranimit të fajësisë në këto raste. Në vetëm një rast, gjykata i shqyrtoi faktet themelore nga të cilat mund të nxirren përfundime dhe ky rasti u mbështet vetëm në lajmërimin publik të 13 janarit 2014. Asnjë nga të pandehurit në këto raste nuk përfaqësoheshin me avokat.

Këto raste nxjerrin në pah mënyrën në të cilën mund të vërehet dallimet në rastet që kanë të bëjnë me deklarimin e pasurisë anembanë Kosovës. Dallimet e tilla ishin të dukshme edhe atëherë kur faktet themelore që lidhen me mosdeklarimin ishin pothuajse identike për secilin të pandehur individual, sikur me rastet e vëzhguara nga komunat në veri të Kosovës. Në raste të caktuara, Agjencia Kundër Korrupsionit duket se i jep rëndësi të madhe njoftimit të zyrtarëve të lartë publikë nga zyrtarët kontaktues, në raste të tjera jo. Për më tepër, prokurorët dhe gjyqtarët individualë reagojnë ndryshe në raste, duke rezultuar në përfundime të ndryshme për personat ndaj të cilëve është ngritur kallëzimi penal. Nevojiten përpjekje për harmonizimin e kësaj praktike dhe për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm të ligjit në rastet e deklarimit të pasurisë, për të shmangur shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës në barazi para ligjit, të cilat garantohen me kornizën ligjore të Kosovës.

---

<sup>41</sup> Shih nenin 3.1.2, më lartë.

<sup>42</sup> Shih nenin 3.2, më lartë.

<sup>43</sup> Duket se këto caktime ishin rezultat i një ndryshimi të politikës në caktimin e rasteve tek zyrat e prokurorive që kanë ndodhur në vitin 2014. Ky ndryshim favorizon vendndodhjen e të pandehurit në vend të vendndodhjes së agjencisë përkatëse qeveritare të përfshirë, në këtë rast Agjencinë Kundër Korrupsionit.

#### **4. PËRFUNDIME**

Vlerësimi i mësipërm tregon se ekzistojnë mospërputhje në zbatim, ndjekje penale dhe gjykim të rasteve penale që kanë të bëjnë me dështimin e zyrtarëve të lartë publikë për të dorëzuar deklarime të pasurisë. OSBE-ja nuk ka arritur të konstatojë një praktikë të njëtrajtshme në përputhje me dispozitat e Ligjit për deklarimin e pasurisë dhe Kodit Penal. OSBE-ja ka vërejtur praktika të ndryshme nga prokuroria në procesimin e këtyre rasteve. Gjithashtu, OSBE-ja ka vërejtur edhe kallëzime penale, aktakuza dhe vendime dhe aktgjykime gjyqësore që nuk kanë përfshirë arsytetime adekuate dhe që nuk i kanë kushtuar vëmendje të duhur rrethanave themelore të dështimit të të pandehurit për të dorëzuar deklaratë të pasurisë, veçanërisht nëse kanë pranuar njoftimin e kërkuar sipas ligjit për deklarimin e pasurisë.

Këto probleme vijojnë me mungesën e përfaqësimit ligjor të të pandehurve në këto raste dhe dështimin e gjykatave për t'i kushtuar konsideratë të duhur nevojës për të ofruar mbrojtje të zgjeruar për të pandehurit e papërfaqësuar, në të gjitha në rastet kur të pandehurit e prekur janë zyrtarë të rinj publikë, siç është rasti në komunat e sapozgjedhura në veri të Kosovës. Rezultati është një serë përfundimesh me mungesë njëtrajtshmërie në tërë Kosovën që minon parimin e sigurisë ligjore dhe të drejtën e barazisë para ligjit.

Janë vërejtur disa zhvillime pozitive. Por, që nga shkurti 2014, Agjencia Kundër Korrupsionit ka filluar të ofrojë trajnime periodike për zyrtarët kontaktues dhe ka publikuar një doracak për ta. Ngjashëm, në vitin 2015, Zyra e Kryeprokurorit ka filluar me përpjekje për harmonizimin e praktikës tek prokurorët, edhe në lidhje me këto raste të veçanta edhe më përgjithësisht, për sa i përket përdorimit të procedurave alternative. Shpresohet se këto përpjekje institucionale do të përcillen me përmirësime të konsiderueshme në zbatimin dhe gjykimin e rasteve të deklarimit të pasurisë.

Megjithatë, zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit, prokurorët dhe gjyqtarët ende kanë nevojë që ta kuptojnë më mirë ligjin që rregullon rastet e deklarimit të pasurisë. Ngjashëm, në kallëzimet penale, aktakuzat, si dhe vendimet dhe aktgjykimet e tyre zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit, prokurorët dhe gjyqtarët duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje fakteve themelore lidhur me dështimin në dorëzimin e deklaratës, në veçanti rolit të zyrtarëve kontaktues në njoftimin e zyrtarëve të lartë publikë mbi detyrimin e tyre për të deklaruar.

#### **5. REKOMANDIME**

##### **Për Agjencinë Kundër Korrupsionit**

- Përveç në rastet kur ka dëshmi të qarta të qëllimit për të mos e deklaruar pasurinë, zyrtarëve të lartë publikë t'u ofrohet mundësua për të korrigjuar veprimin.
- Të ngrihen kallëzime penale vetëm kur është siguruar se zyrtari i lartë publik është kontaktuar nga zyrtari kontaktues për ta njoftuar mbi obligimin për të deklaruar pasurinë.
- Kallëzimet penale të përfshijnë vlerësime gjithëpërfshirëse të dëshmimeve dhe fakteve, për aq sa është e mundur.
- Të vazhdohet me përpjekjet për t'i trajnuar zyrtarët kontaktues në rolet dhe përgjegjësitë e tyre.
- Të udhëzohen zyrat e personelit që të kërkojnë nga zyrtarët e lartë publikë që të nënshkruajnë një njoftim me shkrim mbi detyrimin e tyre për të deklaruar, si pjesë e pakos së tyre informuese të fillimit të punës.

## **Për prokurorët publikë**

- Të bëhen përpjekje për t'i harmonizuar praktikat ndërmjet zyrave prokuroriale të Kosovës, për shembull përmes dhënies së udhëzimeve nga Kryeprokurori lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.
- Të shmangët ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta, nëse kallëzimet penale nuk japin dëshmi dhe fakte të plota të dyshimit të bazuar për qëllimin për të mos deklaruar pasurinë.
- Të rishikohen rastet për të identifikuar alternativa të përshtatshme për procedurë të mëtejme, dhe aktakuzat të ngrihen vetëm nëse ka dëshmi që zyrtari i lartë publik është njoftuar drejtpërdrejt me obligimin për të deklaruar pasurinë.

## **Për gjykatat**

- Të rishikohen me kujdes aktakuzat nga aspekti i përfshirjes së arsytimit të mjaftueshëm sipas fakteve të paraqitura, duke i kushtuar vëmendje nëse i pandehuri është njoftuar në pajtim me Ligjin për deklarimin e pasurisë.
- Të këshillohen të pandehurit e papërfaqësuar për të drejtën e tyre për të kërkuar ndihmë ligjore falas dhe, ndryshe, të merret parasysh mungesa e njohurive/trajnimit ligjor të të pandehurve, për shembull, kur të rishikohen kërkesat për të hedhur poshtë aktakuzën dhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë.
- Të nxirren vendime dhe aktgjykime të arsyetuara mirë dhe, në nivel të apelit, të mos pranohen vendimet dhe aktgjykimet që nuk arrijnë të japin arsyetime adekuate.

## **Për Ministrinë e Drejtësisë**

- Të rishikohet zbatimi i nenit 437 të Kodit Penal dhe ndryshimet e plotësimet në Ligjin për deklarimin e pasurisë në përputhje me *Udhëzimet mbi vlerësimin ex-post të ligjshmërisë* që janë të detyrueshme për të gjitha agjencitë qeveritare dhe ministritë me vendim të Qeverisë të korrikut 2015.

## **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës**

- Në bashkëpunim me prokurorët dhe gjykatat, të hartohet një plan-programi për trajnime për të inkurajuar interpretim dhe zbatim të njëtrajtshëm të nenit 437 të Kodit Penal dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë.

## **Për të pandehurit në rastet e deklarimit të pasurisë**

- Kërkoni këshilla juridike para se të merrni veprime vendimtare, siç është pranimi i fajësisë.
- Nëse nuk mund të përballoni kostot e avokatit, kërkoni që t'ju sigurohet avokati. Këto kërkesa mund të bëhen tek prokurori në fazën e hetimit ose tek gjykatësi pasi rasti të ketë kaluar në gjykatë.